



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE P. - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:059195

Datë: 30.05.2022

Numri i dokumentit: 03071192

PPP.nr.151/2019

GJYKATA THEMELORE NË P.- DEGA ISTOG, si përbarimore, me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike të kreditorit: KRU H... SH.A me seli në P., kundër debitorit: F. H. Rr. p/n K-Istog, për shkak të borxhit në shume prej 2000.90 €, pas prapësimit të ushtruar nga debitori me dt: 29.10.2019 kundër urdhrimit mbi lejimin e përbarimit, gjykata jashtë seance me dt. 30.05.2022 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit F. H. Rr. p/n K-Istog, ushtruar kundër urdhrimit mbi lejimin e përbarimit P.nr.1368/2019 të dt. 11.10.2019, sipas propozimit të kreditorit KRU H... SH.A me seli në P..

A r s y e t i m

Kreditori KRU H... SH.A me seli në P., ka ushtruar propozimin për përbarim të përbaruesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përbarimi ndaj debitorit F. H. Rr. p/n K-Istog, si në shkresat e lëndës me të cilën do të paguaj borxhin në shumë prej 2000.90 €, me kamat ligjore prej 8 % si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, të gjitha këto në afat 7 ditor nga dita e pranimit të urdhrimit, në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare, regjistrimin dhe sekuestrimi e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme dhe pas bllokimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, mjetet e mbledhura të transferohen në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përbarim të dt. 11.10.2019.

Përbaruesi privat me urdhrin përbarimit P.nr.1368/2019 të dt. 11.10.2019, ka lejuar propozimin për përbarim në këtë çështje përbarimore.

Debitori, F. H. Rr. p/n K-Istog, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me shkrim, kundër urdhrimit përbarimor për shkak të shkeljes eseciale të dispozitave të LPP-së, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale me arsyetimin se nr. i matësit është ndryshuar pasi që matësi në emrin tim mban nr. 05675, ndërsa me ka ardhur me nr. 1908, ku asnjë herë me par nuk kam qenë i njoftuar për ndonjë detyrim pasi që dihet se në jetojmë në një zonë ku kemi probleme me ujën pasi që matësi regjistron edhe kur nuk shfrytëzohet uji, ku ka qenë pamundur që të krijohet kjo shumë pasi që gjatë gjithë verës nuk kemi pasur ujë të pijshëm, ku kam kërkuar disa herë që të vijnë me pa matësin mirëpo nuk kanë ardhur. Me tutje shton se përkundër gjendjes së dobët ekonomike, shëndetësore me të cilën përballemi çdo ditë dhe shpenzimeve mjekësore për shërim të djalit, debitori është i gatshëm

prapë te hyj ne një marrëveshje me kreditorin por assesi ne këtë shumë kaq të lart, por të testohet matësi dhe vetëm shuma e cekur ne baze te shfrytëzimit te shërbimeve të arrij marrëveshje për përmbushjen e obligimit, andaj i propozoj gjykatës qe te aprovoj ne tersi prapësimin dhe te refuzohet në tersi propozimi i kreditorit si i pa lejuar, përkatësisht të shfuqizohet urdhri përmbarimor.

Pas prapësimi të ngritur nga debitori, kreditori është njoftuar me te njëjtin por në shkresa të lëndës nuk ka dëshmi qe ka parashtruar përgjigje.

Gjykata Themelore në P.- Dega Istog, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të njëjtin dhe gjeti se i njëjti është i pa bazë. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit nuk tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohet përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat.

Gjykata pas shikimit te shkresave të lëndës, si dhe sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim kur thirret ne atë se është ndryshuar nr. i matësit, asnjëherë nuk kam qen i njoftuar për borxhin si dhe është e pamundur qe te krijohet kjo shumë pasi qe kemi probleme me ujë, te njëjtat pretendime gjykata i refuzoj si te pa bazuara pasi qe propozimi për përmbarim është iniciuar ne bazë te Ekstraktit te verifikuar nga librat afarist me nr. 2012540034, i cili ekstrakt i plotëson kushtet ligjore konform nenit 29 par.1.2 e ne lidhje me par.3 te LPP-së, po ashtu ne shkresa te lëndës nuk ka dëshmi qe debitori ju ka drejtua kreditorit me ndonjë ankesë apo kërkesë lidhur me pretendimet rreth ujit si dhe ujëmatësit, e pretendimet e pa argumentuara me prova gjykata i refuzon si te pa bazuara, për më tepër debitori prapsmin nuk e ka të mbështetur asnjëherë nga shkaqet e prapësimi te paraparë në nenin 69 dhe 71 te LPP-së.

Se debitori i obligohet kreditorit si në propozim për përmbarim, këtë fakt gjykata e bazon në nenin 245 par.1 te LMD-së i cili nen parasheh se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, ndërsa par.2 i po te njëjtit nen parasheh se “Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak”.

Gjykata konform nenit 17 të LPP-së aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, e konform dispozitave të nenit 3, 17, 29 par.1.2 dhe par.3, 37, 38, 69, 71, 73 par. 3 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, e në lidhje me nenin 245 par.1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË P.- DEGA ISTOG
PPP.nr.151/2019 dt.30.05.2022

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta ne ankese, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit te të njëjtit, Gjykatës se Apelit ne Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.